

RËNDËSIA E KOMPETENCAVE NDËRKULTURORE DHE SHUMËGJUHËSORE NË INDUSTRIJË E TURIZMIT NË SHQIPËRI

Dr. ARDITA DYLGJERI

Universiteti "Aleksandër Xhuvani"
arditadylgjeri@live.com

Msc. IRGEN XHYRA

Gjimnazi Gjuhësor "Mahmut e Ali Cungu"
irgen.xhyra@gmail.com

ABSTRACT

Intercultural and multilingual competences are becoming key characteristics of successful tourism professionals. Tourism workers of today must possess not only adequate tourism related knowledge but also skills needed for intercultural communication. The term *intercultural competence* is undoubtedly one of the most complex and problematic ones, since a lot of confusion existed on what this term is. Multilingualism, international communication, transcultural competence, global competence and citizenship, cross-cultural awareness, intercultural sensitivity are regarded as other terms related to *intercultural competence*, which undoubtedly contribute to the improvement and further development of tourism. This paper aims at promoting and raising awareness on the importance of developing both intercultural and multilingual competence in the area of cultural tourism, catering and hospitality. In a world of continuous globalization and constant movement, there is no escaping intercultural contacts and communication, especially in the field of tourism and hospitality. What is more important to be discussed is certainly the role that pre – university and university education and their correspondent subjects and curricula have in the development and improvement of such needed skills in the tourism industry.

Keywords: intercultural competence, multilingual competence, tourism, Albania, communication, education.

Shqipëria, si një destinacion turistik pak i njohur, sot përballet me Srritje të interesit të vizitorëve europianë, dhe më gjerë. Gjithmonë e më shumë, si në rrafshin politik, ashtu edhe në atë ekonomik, turizmi po tentohet të cilësohet si një burim i rëndësishëm i zhvillimit të ekonomisë. Për këtë arsye, diversifikimi i ofertës turistike, nga ajo balneare, e përqendruar kryesisht në plazhet e jugut, drejt një turizmi gjithëvjeter dhe hapja e mëtejshme e ofertës turistike drejt një turizmi kulturor dhe identitar. Oferta aktuale e turizmit synon një shkëputje nga elitarizmi i turizmit kulturor, duke i kushtuar vëmendje kërkesave të një tregu në zhvillim dhe ndryshim, sidomos kur tashmë koncepti i turizmit kulturor shihet jashtë ngurtësisë së muzeve apo formave të tjera të pasqyrimin të trashëgimisë kulturore të një vendi, kombi, rajoni etj. Turisti i gjeneratës së re kërkon shkrirje të eksperiencës turistike, duke tentuar që të përfitojë sa më shumë brenda një periudhe kohe të kufizuar. Eksperienca turistike sot, ndryshon shumë nga ajo e viteve '90 apo fillimit të mijëvjeçarit të ri. Tanimë, turizmi duhet të jetë më “demokratik”, më aktiv, të japë ndjesinë e aventurës etj. Konceptet “elitariste” janë drejt zhdukjes dhe turistët kërkojnë një treg dhe shërbim më “elastik”. Pasojë e drejtpërdrejtë e këtyre faktorëve, është domosdoshmëria e përgatitjes, jo vetëm e personelit të shërbimit, por edhe të komunitetit pritës së turistit për këtë sfidë të re.

Nga ana tjetër, në kushtet e hapjes së vendit tonë, në kuadër të politikave integruese europiane, turizmi nuk ka thjesht synim çlodhjen, por edhe përfshirjen e turizmit kulturor në oferta të tjera turistike që po japin efektin e vet ekonomik në turizmin shqiptar. Ndaj, është e domosdoshme që vlerësimi i trashëgimisë kulturore shqiptare nga operatorët turistikë të ecë në të njëjtin hap dhe drejtim me atë çka turisti europian kërkon të përjetojë. Botëkuptimi europian, i bazuar mbi një sistem të mirëlllogaritur të vlerave kulturore, të cilat duhet të përçohen nga arsimi, nxit diversitetin, vetëdijen kulturore dhe nacionale, krijimin e eksperiencave individuale përkundrejt atyre kolektive etj. Sistemi arsimor europian nxit përfituesin e tij, qytetarin europian, drejt të menduarit analitik dhe krijues, të hapur drejt eksperiencave kulturore të reja, qofshin këto edhe eksperienca gjuhësore. Në fund të fundit, gjuha është bartëse e të njëjtave elemente kulturore dhe është zhvilluar në ndikimin e të njëjtëve faktorë si dhe

elementet e tjera identitare të një populli¹. Po kështu, turistët e ditëve të sotme, në mënyrë të veçantë të lindurit në mijëvjeçarin e ri, janë produkt i prirjeve me natyrë globaliste, gjithëpërfshirëse etj.

Një ndër problematikat thelbësore më të cilat duhet të përballet sistemi arsimor është aftësimi i nxënësve/studentëve (shoqërisë) për t'u përballur me tregun e punës². Ky treg, ashtu si dhe shoqëria, është në evoluim të vazhdueshëm dhe bazat e arsimit nuk duhet të jenë vetëm dije, por dhe aftësi dhe shkathtësi, të cilat do t'i mundësojnë profesionistëve të fushës së turizmit t'u përgjigjen kërkesave në rrite të kësaj industrie.

Në përgjigje të këtyre sfidave, BE, që në fillim, vuri theksin në përcaktimin e qartë të atyre vlerave, të cilat do të lehtësonin krijimin e një entiteti të vetëm ekonomik dhe tregtar, politik, si dhe kulturor. Vetëm në këtë mënyrë, sipas Churchill-it, do të shmangeshin tendencat e nxitjes së luftërave të reja në Europë³ dhe, në çdo rast, kultura përbënte thelbin e identitetit të ri europian. Nënshkrimi i Traktatit të Mastroitit (1992) bëri që integrimi europian të mos konsiderohej thjesht një bashkim mekanik, por një bashkim i vlerave dhe për më shumë i një botëkuptimi gjithë përfshirës. Ky i fundit mund të realizohej duke përfshirë në bazë të sistemit të edukimit të vlerave, elementet kulturore me diapazon të gjerë. Synimi i BE-së në këtë drejtim, duhej të nxiste zbutjen e dallimeve kulturore dhe njëkohësisht eliminimin e uniformitetit kulturor⁴. Për më tepër, kompetencat që duhej të vireshin në thelb të arsimimit në BE, përfshinin dhe elemente të edukimit të gjuhëve, ku përcaktohej që duhej të kishte një numër minimal prej dy gjuhësh të huaja, të cilat duhej të përfshiheshin në sistemin arsimor europian⁵ (shiko figurën 1). Po ashtu, aftësimi i komunikimit në më shumë se një gjuhë të huaj do të nxiste plotësimin më cilësor të kompetencave kulturore⁶. Dhe, më tej, në përshkrimin e kompetencës kulturore gjendet përshkrimi i saj si një tërësi njohurish dhe aftësish, të cilat nxisin jo vetëm aftësitë për të njohur dhe për t'u ndërgjegjësuar për

¹ Çabej E. (2008) *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, pjesa e parë, Çabej, Tiranë, f. 9

² Komisioni Europian (2006), *Key competences for lifelong learning*. f. L 384/8

³ Churchill, W. S. (2014). *Europe Unite*. (Vëll. i 2). Rosetta Books.


⁴ Komisioni Europian (1995) *White Paper on Education and Training - Teaching and Learning - Towards the Learning Society*, f. 2,4, 7, 10

⁵ Po aty, f. 13

⁶ Komisioni Europian, *Key competences for lifelong learning*. (2006). f. L 394/14

vlerat kulturore nacionale, por njëkohësisht edhe për të pranuar dhe njohur vlerat kulturore të individëve që u përkasin kulturave të tjera. Në këtë prizëm përfshihet dhe dialogu ndërkulturor në rrafsh të ndryshme⁷.

Figura 1. Koncepti europian i të mësuarit përgjatë gjithë jetës.



Kompetencat ndërkulturore dhe shumëgjuhësore

Termi kompetencë ndërkulturore është padyshim një nga më komplekset dhe më problematiket. Deri vonë, ekzistonte një konfuzion i madh se çfarë nënkupton në të vërtetë ky term. Shumëgjuhësia, komunikimi ndërkombëtar, kompetenca ndërkulturore, kompetenca dhe qytetaria globale, ndërgjegjësimi ndërkulturor, ndjeshmëria ndërkulturore janë vetëm disa nga termat që, në shumë raste, janë përdorur në lidhje ose në mënyrë të ndërsjellë me kompetencën ndërkulturore. Në vitin 2006, Deardorff propozoi një model të kompetencës ndërkulturore që përbëhet nga 15 komponentë të ndarë në 4 kategori (të ndërlidhura): qëndrimet, njohuritë dhe të kuptuarit,

⁷ Po aty, f. L 394/18.

European Education and Culture Executive Agency, Eurydice, *Promoting citizenship and the common values of freedom, tolerance and non-discrimination through education: overview of education policy developments in Europe following the Paris Declaration of 17 March 2015*, Publications Office, 2016, <https://data.europa.eu/doi/10.2797/396908>, f. 3, 6-10.

rezultati i dëshiruar i jashtëm dhe rezultati i dëshiruar i brendshëm. Për më tepër, Deardorff propozoi një përkufizim të kompetencës ndërkulturore, duke pohuar se kompetenca ndërkulturore është “aftësia për të komunikuar në mënyrë efektive dhe të përshtatshme në situata ndërkulturore bazuar në njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet ndërkulturore”⁸.

Sipas Byram, “kompetenca ndërkulturore përfshin njohuritë, qëndrimin, aftësitë e zbulimit dhe ndërveprimet, aftësitë e interpretimit dhe lidhjes dhe ndërgjegjësimin kritik të një kulture”⁹. Për më tepër, “ajo është përcaktuar si një formë e aftësisë së një personi për t’u sjellë në mënyrë adekuate dhe fleksibile kur përballet me qëndrimet, pritjet dhe veprimet e përfaqësuesve të kulturave të huaja”¹⁰.

E përbashkëta e të gjitha këtyre përkufizimeve është ky “element” i komunikimit që lidh kompetencën ndërkulturore me mësimin e gjuhëve të huaja dhe kompetencën shumëgjuhësore. Përkatësisht, zhvillimi i kompetencës ndërkulturore përfshin trajnimin ndërkulturore dhe shkëmbimin e ideve. Përpos kësaj, mësimi i gjuhëve të huaja luan një rol jetik në këtë proces. Mësimi i disa gjuhëve lehtëson gjithashtu zhvillimin e kompetencës ndërkulturore. Kompetenca shumëgjuhësore mundëson shkëmbimin e informacionit dhe opinionit me cilësi të lartë¹¹ midis një numri edhe më të madh anëtarësh të kulturave të ndryshme dhe kështu i hap rrugën zhvillimit më të shpejtë të kompetencës ndërkulturore (që është një proces mjaft i ngadalshëm për shkak të kompleksitetit të tij). Për më tepër, personat që flasin shumë gjuhë thuhet se posedojnë ndërgjegjësim të shtuar metagjuhësor, kreativitet dhe fleksibilitet më të madh njohës dhe aftësi mendore më të larmishme¹² të cilat ndikojnë shumë në zhvillimin e kompetencave kryesore të

⁸ Deardorff, D. K. (2006) *The Identification and Assessment of Intercultural Competence as a Student Outcome of Internationalization at Institutions of Higher Education in the United States*, Journal of Studies in International Education, 10(3), 241–266, f. 247.

⁹ Byram, M. (2000), *Assessinginter cultural competence in language teaching*. Sprogforum 18, 8-13.

¹⁰ Mayer, M. (1991) Developing transcultural competence: Case studies of advanced language learners. In D. Buttjes& M. Byran (Eds.), *Mediating language sand cultures: Towards an intercultural theory of foreign language education*, 136-158. Clevedon: Multilingual Matters.

¹¹ Sindik, J., Bozinovic, N. (2013) *Importance of foreign languagesfor a career in tourism as perceived by students in differentyears of study*, Tranzicija, 15(31), 16-28.

¹² Cook, V. (1995) *Multi-competenceand the learning of manylanguages*. In M. Bensoussan, I. Kreindler & E. Aogain (ed.) *Multilingualismand languagelearning*, 8 (2). Language, cultureand Curriculum, 93-98. Clevedon: Multilingual Matters.

përcaktuara nga Korniza Europiane e Referencës për kompetencat kyçe për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Shumë nga këto kompetenca janë pjesë e kompetencave profesionale për specialistët e turizmit. Luka pohon se kompetenca e veprimtarisë profesionale të specialistëve të turizmit përbëhet nga kompetenca njohëse, kompetenca personale (përfshirë kompetenca ndërkulturore) dhe kompetenca teknologjike-profesionale.

Figura 2 Paraqitje grafike e peshës së turistëve vendas dhe të huaj





Figura 3 Turistë sipas qëllimit



Kompetencat ndërkulturore e shumëgjuhësore dhe realiteti shqiptar

Në vazhdë të përpjekjeve për t'u integruar në BE, dhe në dokumentet kryesore, të cilat rregullojnë sistemin arsimor shqiptar, kompetencat që lidhen me aftësi dhe shkathtësi multikulturale, ndërkulturore, dhe gjuhësore zënë një vend të rëndësishëm. Në zbatim të këtyre parimeve në vitin 2012 Kuvendi, në ligjin 69/2012 **“Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”**, përcaktoi, në nenin 3, si detyrë të sistemit arsimor:

Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim formimin e çdo individi, në mënyrë që të përballojë sfidat e së ardhmes, të jetë i përgjegjshëm për familjen, shoqërinë e kombin dhe në mënyrë të veçantë:

a) të njohë, të respektojë, të mbrojë identitetin kombëtar e të zhvillojë trashëgiminë dhe diversitetin tonë kulturor; ... d) të njohë dhe të respektojë traditat e popujve të tjerë; të ndërgjegjësohet për të përmbushur përgjegjësitë e tij për mbrojtjen e mjedisit.

Siç shihet dhe nga më lart, sistemi arsimor në Republikën e Shqipërisë ka që në bazë të organizimit të tij, edukimin e vlerave me natyrë identitare, në një raport të drejtëme ndjekjen e një forme të jetës bazuar tek bashkëjetesa dhe respekti për vlerat e tjetrit. Me amendimin e ligjit në vitin 2015, paraqitet një parashikim më i plotë i detyrave të sistemit arsimor në RSH. Kështu ky nen ndryshon në formën e tanishme:

1. Sistemi arsimor parauniversitar ka për qëllim krijimin e kushteve dhe mundësive që nxënësit:

...b) të zhvillohen në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; c) të kontribuojnë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballjen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës...

2. Në arsimin parauniversitar nxënësit:

a) kultivojnë identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore; b) përvetësojnë vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare; ...d) aftësohen për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore; dh) aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës; e) zhvillojnë shpirtin e sipërmarrjes; ...

Në ligjin për Arsimin e Lartë në nenin 1 pikaç sanksionon:

ç) të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal ...

Siç shihet, në të dy ligjet, kur flitet për zhvillim kulturor, i kushtohet rëndësi e veçantë zbatimit të tyre, që do të nxisë në mënyrë të vazhdueshme dhe kompetencat e përkatëse. Nga studimi i gjendjes në sistemin arsimor profesional por dhe në atë të lartë, është vënë re se metodat e përdorura pengojnë zhvillimin e kompetencave individuale, në mënyrë të drejtpërdrejtë ato të lidhura me aftësitë sipërmarrëse dhe ato të lidhura me kompetencat e të nxënës për të nxënë. Kjo lidhet dhe me faktin se metodat e përdorura dhe mendësia mbi të cilën janë ngritur kurrikulat dhe e gjithë puna dhe veprimtaria, është bazuar në metoda dhe forma të vjetruara¹³.

¹³ Kompetencat e të mësuarit për të nxënë dhe e të mësuarit të sipërmarrjes në arsimin e mesëm

Implementimi i suksesshëm i një kurrikule të përditësuar në përputhje me Kornizën Kurrikulare Europiane, do të nxisë, në mënyrë të vazhdueshme, jo vetëm përmirësimin e pozitës së të rinjve shqiptarë në tregun europian, por dhe shërbimin në tregun e turizmit në vendin tonë.

Nxiti e kompetencave të lidhura me gjuhët, qofshin amtare qofshin të huaja, do t'i japin hov, të paktën në kushtet e Shqipërisë, zhvillimin e turizmit, veçanërisht atij kulturor. Vitet e fundit, kanë dëshmuar rritje të peshës të turistëve të huaj në tregun shqiptar (shiko figurat 2 dhe 3). Për më tepër, dhe varësia e madhe e ekonomisë sonë nga remitancat, e kanë vendosur turizmin jo vetëm në qendër të vëmendjes së investitorëve, por kanë rritur nevojën për përgatitjen e stafit dhe të personelit të shërbimit në industrinë e turizmit.

Sistemi shqiptar i edukimit nuk ka patur mundësi të krijojë burime njerëzore, të cilët kanë aftësi konkurruese në tregun e punës së turizmit. Kjo situatë vjen si pasojë e një sërë faktorësh. Së pari, ekziston një hendek mes asaj që zhvillohet në auditor dhe aftësive që realisht duhen në treg¹⁴. Kështu, kur vjen fjala për kompetencat mbi sipërmarrjen, vlerësimi i përgjithshëm, fatkeqësisht edhe për nivelin universitar, është “se kemi të bëjmë me diçka të lidhur me biznesin dhe ekonominë”¹⁵. Mungesa e vizionit për të nxitur zhvillimin e kompetencave të plota dhe të nxënë të aktiv duhet të konsiderohet si ngushtësisht e lidhur me mënyrën sesi ne përgatisim stafin mësimdhënës dhe me kufizimet që sistemi dëshmon në rekrutimin e tij. Kjo e bën sistemin e ngurtë dhe të aftë të krijojë boshllëqe në zhvillimin e kompetencave¹⁶.

Domosdoshmëri të dorës së parë merr edukimi i bazuar në arritjen e kompetencave nisur dhe nga orientimi i zhvillimit ekonomik të zonave rurale drejt agroturizmit¹⁷. Zhvillimi i turizmit në këtëkahje nuk

profesional dhe në arsimin e lartë në Shqipëri (2007), www.etf.europa.eu/sites/default/files/m/C125788C00311F89C12576800061E995_NOTE7YCNWD.pdf (ETF), f. 20,25,29, 32.

¹⁴ Zendeli Mislim (2006), *Menaxhuesit dhe shërbimet cilësore në industrinë e mikpritjes dhe turizmit*, Revista Monitor, <https://www.monitor.al/menaxhuesit-dhe-sherbimet-cilesore-ne-industrine-e-mikpritjes-dhe-turizmit/>

¹⁵ Kompetencat e të mësuarit për të nxënë dhe e të mësuarit të sipërmarrjes në arsimin e mesëm profesional dhe në arsimin e lartë në Shqipëri (2007), www.etf.europa.eu/sites/default/files/m/C125788C00311F89C12576800061E995_NOTE7YCNWD.pdf (ETF), f. 29, 32.

¹⁶ Po aty f. 33

¹⁷ Rama E. (2019), *Agroturizmi, transformim i potencialeve të fjetura në burim rritjeje ekonomike*, <https://kryeministria.al/newsroom/agroturizmi-transformim-i-potencialleve-te-fjetura-ne-burim>

ka vetëm elemente pozitive. Kështu, në çdo njësi që ofron shërbimin turistik do të lipsej minimalisht angazhimi i një operatori me aftësi të mira komunikuese në gjuhën amtare, në gjuhë të huaja, dhe, për më tepër, me aftësitë dhe shkathtësitë bazë të kompetencave kulturore dhe ndërkulturore. Në kushtet, kur, aktualisht nga Forumi Botëror Ekonomik, turizmi kulturor merr 1.2 nga 7 të mundshme, duhet të vihet theksi te plotësimi i standardeve të lidhura me këto kompetenca në mënyrën sa më të plotë të mundshme.

Nëse në kompetencat e lidhura me sipërmarrjen dhe komunikimin në gjuhën amtare dhe gjuhë të huaja shënohen arritje të vlerësueshme, kur vjen çështja tek kompetencat qytetare dhe ato të kulturës dhe të shprehjes së saj, sistemi aktual arsimor shqiptar shënon problematika të theksuara. Kështu, programi i zhvillimit të lëndëve përkatëse është i cunguar dhe paraqet në mënyrë të dukshme mangësinë e përshtatjes me nevojën e tregut të turizmit. Pasojë e drejtpërdrejtë e saj është marketingu i keq, diseminimi i informacionit në mënyrë të gabuar etj. Një pengesë madhore e realizimit të këtyre kompetencave është vlerësimi i tyre si pjesë tëveçuara të programit dhe kurrikulës. Kështu, si në këndvështrimin e mësimdhënësve ashtu dhenë atë të pjesës më të madhe të shoqërisë, këto lëndë shihen jo vetëm si jo të rëndësishme, por dhe si të dorës së dytë.

Mundësi dhe kapacitete

Nëse do të shohim me kujdes problematikën e hasur në zhvillimin e turizmit, një prej çështjeve kryesore është marrja e vendimeve në mënyrë të gabuar nga sipërmarrësit e rinj në fushën e turizmit. Po kështu, nga sistemi arsimor parauniversitar rezulton që nxënësit të shkojnë në universitet pa përgatitjen e duhur. Ata nuk kanë shkathtësitë për të përpunuar njohuritë e reja dhe vlerësimin e njohurive në mënyrë kritike dhe krijuese, elemente këto që ndikojnë në cilësinë e studentëve dhe profesionistëve të mëvonshëm¹⁸. Nga ana tjetër, turizmi ndikohet

-rritjeje-ekonomike/

18 Kompetencat e të mësuarit për të nxënë dhe e të mësuarit të sipërmarrjes në arsimin e mesëm profesional dhe në arsimin e lartë në Shqipëri. (2007), www.etf.europa.eu/sites/default/files/m/C1

dukshëm dhe nga mungesa e interesit për t’u edukuar në një nivel realisht profesional në Shqipëri.

Megjithatë, me fitimin e eksperiencës, situata po përmirësohet dhe po vihet re angazhim më i madh i partnerëve në edukimin e bazuar në kompetenca. Kështu, po vihet re orientimi i shkollave drejt aplikimit të atyre moduleve që krijojnë *soft skills* tek përfutuesit e shërbimit. Module si *Guida turistike, Kompania e nxënësve* etj. shërbejnë si një formë e përmbledhjes së njohurive dhe vëniessë tyre në praktikë. Një tjetër element është përfshirja e një gjuhe të dytë në arsimin parauniversitar, e cila padyshim nxit zhvillimin e kompetencave jo vetëm gjuhësore, por edhe kulturore të vendit/kombit që e mbart.

Në nivelin universitar, një zhvillim i mirë menduar është dhe hapja e programeve studimore me karakter profesional. Këto programe do të duhet të diversifikohen në mënyra më të efektshme dhe duhet të promovohen në mënyrë të vazhdueshme nga të gjithë aktorët. Po kështu një element që nxit në një mënyrë të qenësishme zhvillimin e turizmit kulturor janë dhe shkëmbimet kulturore në kuadër të programeve të financuar nga BE ose dhe partnerë të tillë. Në mënyrë të veçantë, një rëndësi të madhe kanë programet e Erasmus dhe Erasmus + të cilat u mundësojnë studentë studentëve dhe stafeve akademike dhe ndihmës akademike të shkëmbejnë aftësi, kompetenca, arritje shkencore dhe eksperiencia ndërkulturore. Individët e angazhuar në të tilla programe bëjnë prezantime jo vetëm të kulturave të tyre të origjinës, por dhe sjellin me vete elemente të kulturës që i përvetësojnë gjatë qëndrimit në vende të tjera. Nga ana tjetër, këto përvoja shërbejnë dhe si mundësi promovimi për pasuritë kulturore dhe natyrore të shteteve të ndryshme duke krijuar në këtë mënyrë turistin potencial të së ardhmes.

Përfundime

Turizmi, si një nga degët më të rëndësishme të ekonomisë sonë, ka nevojë për mbështetje jo vetëm financiare dhe politike, por dhe për krijimin e kushteve të duhura për mirëfunksionimin e operatorëve

të suksesshëm. Sistemi arsimor shqiptar, në një periudhë të gjatë reformimi në aplikimin e mësimdhënies me kompetenca, do të duhet t'i japë përgjigje një sërë kërkesash të tregut gjithnjë në evoluim.

Nxitja e kompetencave të përfuturit të gjuhës amtare dhe gjuhëve të huaja do të krijojë parakushte të rëndësishme për plotësimin e kriterëve të tjera. Në mënyrë të veçantë, ajo do të nxisë zhvillimin e aftësive individuale të nxënësve dhe studentëve për të rritur sipërmarrjen në fushën e turizmit. Ndikim të madh në këtë aspekt, do të ketë realizimi i këtyre kompetencave në gjetjen e ngjashmërive dhe pikave të përbashkëta të kulturave të bartura nga ofruesi i shërbimit dhe përfuturi.

Zhvillimi i kompetencave kulturore dhe shprehja e tyre duhet të jenë të përfaqësuara më mirë në programet dhe kurrikulën arsimore. Nëse ne do të duhet të nxisim turizmin gjithë vjetor, turizmi kulturor do të marrë një pozitë më të rëndësishme. Një treg, si ai i turizmit kulturor, i cili është konsideruar si elitare, është dinamik dhe industria e mikpritjes ka nevojë për të krijuar një staf të aftë të ofrojë shërbime dhe për brezin e ri, duke e shkëputur turizmin kulturor nga centralizimi, në një rrugëtim drejt demokratizimit.

Është e domosdoshme që mësimdhënia me bazë kompetencat, në çdo nivel të arsimit të shkëputet si nga programet e vjetruara dhe nga mënyra e konceptimit të tyre. Mësimdhënia duhet të jetë më elastike dhe të nxisë të menduarit kritik dhe krijues, duke inkurajuar njëkohësisht aftësitë sipërmarrëse dhe ato qytetare.

Mësimdhënia me bazë kompetencat nxit përpos të tjerash të menduarit kritik dhe aftësinë për të mësuar përgjatë jetës, duke mundësuar zhvillimin e vazhdueshëm dhe përmirësimin e aftësive të operatorëve.

Po ashtu, programet e shkëmbimit të studentëve, si psh. programet Erasmus +, nxisin zhvillimin e këtyre kompetencave dhe përfuturin e shkathtësive të reja. Shkëmbime të tilla, përveç karakterit akademik, do të mundësojnë marrjen e eksperiencave dhe në fushën e turizmit kulturor. Shpesh eksperiencat personale janë më të vlefshme se orët e mbyllura në auditorë, ku mësimdhënia, edhe pse në përmirësim,

duhet të marrë karakter më praktik se teorik, më dinamik se statik, më demokratik se të qendëruar.

BIBLIOGRAFI

- BYRAM, M. (2000), *Assessing intercultural competence in language teaching*. Sprog forum 18, 8-13.
- CHURCHILL, W. S. (2014). *Europe Unite*. (Vëll. i 2). Rosetta Books.
- ÇABEJ E. (2008). *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, pjesa e parë, Çabej, Tiranë.
- DEARDORFF, D. K. (2006) *The Identification and Assessment of Intercultural Competence as a Student Outcome of Internationalization at Institutions of Higher Education in the United States*, *Journal of Studies in International Education*, 10(3), 241–266, f. 247.
- ETF (2007), *Kompetencat e të mësuarit për të nxënë dhe e të mësuarit të sipërmarrjes në arsimin e mesëm profesional dhe në arsimin e lartë në Shqipëri*, www.etf.europa.eu/sites/default/files/m/C125788C00311F89C12576800061E995_NOTE7YCNWD.pdf
- KOMISIONI EUROPIAN, (1995). *White Paper on Education and Training - Teaching and Learning - Towards the Learning Society*
- KOMISIONI EUROPIAN, (2006), *Key competences for lifelong learning*.
- MAYER, M. (1991). *Developing transcultural competence: Case studies of advanced language learners*. In D. Buttjes & M. Byran (Eds.), *Mediating language and cultures: Towards an intercultural theory of foreign language education*, 136-158. Clevedon: Multilingual Matters.
- RAMA E. (2019). *Agroturizmi, transformim i potencialeve të fjetura në burim rritjeje ekonomike*, <https://kryeministria.al/newsroom/agroturizmi-transformim-i-potencialeve-te-fjetura-ne-burim-rritjeje-ekonomike/>
- ZENDELI M. (2006), *Menaxhuesit dhe shërbimet cilësore në industrinë e mikpritjes dhe turizmit*, *REVISTA MONITOR*, <https://www.monitor.al/menaxhuesit-dhe-sherbimet-cilesore-ne-industrine-e-mikpritjes-dhe-turizmit/>